

## SHËRBIMET E SMG-së

### KUSHTET E SHËRBIMIT

**Data efektive:** mars 2018

Këto Kushte të Shërbimit së bashku me Politikën e Privatësisë së SMG-së ("**Kushtet**") përshkruajnë kushtet e përgjithshme në bazë të të cilave Service Management Group, LLC dhe bashkëpunëtorët e tij ("**SMG**" ose "ne" ose "neve") ju ofrojnë qasje në sajte të uebit, shërbime dhe aplikacione, duke përfshirë aplikacionet celulare, me të cilat këto Kushte janë të lidhura ose u referohen (së bashku, "**Shërbimet e SMG-së**").

Para qasjes dhe përdorimit të Shërbimeve të SMG-së, lexojini me kujdes këto Kushte; ato përbëjnë një marrëveshje ligjore midis SMG-së dhe jush.

DUKE PËRDORUR NDONJËRIN PREJ SHËRBIMEVE TË SMG-SË, JU BINI DAKORD ME KËTO KUSHTE DHE VËRTETONI SE JENI NË GJENDJE DHE TË AFTË NGA ANA LIGJORE PËR TA BËRË NJË GJË TË TILLË. NËSE PËRDORNI SHËRBIMET E SMG-SË NË EMËR TË PUNËDHËNËSIT TUAJ, PRANIMI NGA ANA JUAJ I KËTYRE KUSHTEVE KONSIDEROHET NJË MARRËVESHJE MIDIS PUNËDHËNËSIT TUAJ DHE SMG-SË, DHE SE JU PËRFAQËSONI DHE GARANTONI SE KENI AUTORITETIN QË TA ANGAZHONI PUNËDHËNËSIN TUAJ ME KËTO KUSHTE.

**SHËNIM I RËNDËSISHËM:** Këto Kushte përmbajnë dispozita të cilat kufizojnë detyrimin tonë ndaj jush dhe kërkojnë që t'i zgjidhni mosmarrëveshjet me ne nëpërmjet arbitrazhit përfundimtar dhe detyruet në bazë individuale dhe jo si pjesë e ndonjë veprimi klase apo përfaqësues. Shihni "VLEFSHMËRIA E KONTRATËS, MOSPRANIMI I GARANCIVE DHE KUFIZIMET E PËRGJEGJËSISË" (Seksioni 7) dhe "ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE" (Seksioni 9) më poshtë për më shumë informacion.

**NËSE NUK BINI DAKORD ME TË GJITHA KËTO KUSHTE TË PËRCAKTUARA NË KËTO KUSHTE TË SHËRBIMIT DHE POLITIKËN E PRIVATËSISË SË SMG-SË, NUK MUND TË PËRDORNI SHËRBIMET E SMG-SË.**

#### 1. NDRYSHIMET E KUSHTEVE

Dita efektive e Kushteve përcaktohet në krye të këtij sajti të uebit. Kur shtojmë tipare të reja, ne mund t'i ndryshojmë këto Kushte. SMG-ja mund t'i ndryshojë këto Kushte në çdo kohë duke përditësuar Kushtet. Ju duhet t'i bindeni ndonjë ndryshimi të tillë; prandaj, vizitoni këtë faqe herë pas here që t'i shqyrtoni këto Kushte. Përdorimi juaj i vazhdueshëm i Shërbimeve të SMG-së pasi Kushtet e ndryshuara të postohen përbën pranimin tuaj të Kushteve të ndryshuara. Kushtet e ndryshuara zëvendësojnë të gjitha versionet e mëparshme të marrëveshjeve, njoftimeve ose deklaratave rreth Kushteve, por ndryshimet nuk zbatohen në mënyrë retroaktive.

## 2. KUSHTET SHITESË

Disa shërbime të ofruara nga ose nëpërmjet Shërbimeve të SMG-së, të tilla si aplikacionet celulare, lotaritë, konkurset dhe shërbimet e tjera, mund të drejtohen nga kushte dhe rrethana shtesë të paraqitura së bashku me to ("Kushtet Shtesë"). Ju duhet të pranoni Kushtet Shtesë para se të përdorni shërbime të tilla. Çdo Kusht Shtesë duhet të zbatohet si shtesë e këtyre Kushteve. Nëse ndonjë dispozitë e Kushteve Shtesë është në konflikt me ndonjë dispozitë të këtyre Kushteve, Kushtet Shtesë do të mbizotërojnë mbi dispozitën e papajtueshme në këto Kushte vetëm deri në masën e papajtueshmërisë.

## 3. PRIVATËSIA/SIGURIA

Para se të përdorni Shërbimet e SMG-së, lexoni me kujdes Politikën e Privatësisë së SMG-së që të mësoni në lidhje me të dhënat personale që mbledh SMG-ja në Shërbimet e SMG-së, se si i përpunojmë dhe me kë mund t'i ndajmë të dhënat personale. Mund të gjeni një kopje të Politikës së Privatësisë së SMG-së në:

## 4. PËRMBAJTJA E SMG-SË

Shërbimet e SMG-së, duke përfshirë ndonjë informacion, grafikë, imazhe, punë arti, tekst, videoklip, përpilim të dhënash, softuer, audio të shkurtra, marka tregtare, marka të shërbimit, evidenca, emra tregtarë dhe përmbajtje të tjera të dhëna nga, në ose nëpërmjet Shërbimeve të SMG-së (së bashku, "**Përmbajtja e SMG-së**") janë pronë e SMG-së, bashkëpunëtorëve tanë, partnerëve, kompanive të licencuara ose të përfaqësuara dhe mbrohen nga e drejta e autorit, patenta e markës tregtare dhe ligjet e tjera, si të Shteteve të Bashkuara ashtu dhe të huaja. Përveçse si përcaktohet në seksionin më poshtë të licencës së kufizuar, apo siç kërkohet nga ligji i zbatueshëm, asnjë e drejtë e autorit, markat tregtare, pronat e tjera intelektuale ose ndonjë pjesë e Shërbimeve të SMG-së nuk mund të përdoret, prodhohet, kopjohet, shitet, rishitet, merret, ndryshohet ose me fjalë të tjera të shfrytëzohet, plotësisht ose pjesërisht, për ndonjë qëllim pa miratimin e mëparshëm me shkrim. Përdorimi i paautorizuar i Përmbajtjes së SMG-së mund të shkelë të drejtën e autorit, markave tregtare dhe ligjeve të tjera.

Nëse bini dakord me këto Kushte (si dhe me kushtet të përgjithshme shtesë të lidhura drejtpërdrejt me Përmbajtjen e SMG-së), SMG ju jep një licencë personale, të revokueshme, joekskluzive, jo të transferueshme dhe të kufizuar (pa të drejtën e nënlicencimit) të qasni dhe përdorni Shërbimet e SMG-së dhe të shkarkoni, printoni dhe/ose kopjoni Përmbajtjen e SMG-së vetëm për përdorimin tuaj personal dhe që i nënshtrohet këtyre Kushteve. Ju pranoni se sekretet tregtare dhe pronësia intelektuale të trupëzuara në Shërbimet e SMG-së nuk ju janë dhe nuk do t'ju licencohen ose, me fjalë të tjera, nuk do t'ju bëhen të ditura. Ju pranoni se kodi HTML që krijon SMG-ja për të prodhuar faqet e Shërbimeve mbrohet nga të drejtat e autorit të SMG-së. Të gjitha të drejtat që nuk janë dhënë shprehimisht këtu janë të rezervuara nga SMG-ja.

Ju bini dakord se, nëse SMG-ja nuk ju jep autorizim të mëparshëm me shkrim për ta bërë një gjë të tillë, ju nuk:

- a. do të përfshini asnjë Përmbajtje të SMG-së në ndonjë punë tjetër (të tillë si sajti juaj i uebit) ose ta përdorni Përmbajtjen e SMG-së në ndonjë mënyrë publike ose tregtare;
- b. do të ndryshoni ndonjë njoftim në lidhje me të drejtën e autorit, markat tregtare ose të drejta të tjera të pronës intelektuale që mund të jenë pjesë e Përmbajtjes së SMG-së; ose
- c. do të "lidheni thellësisht" me ndonjë nga Shërbimet e SMG-së (p.sh. lidhje me ndonjë faqe tjetër të ndryshme nga faqja kryesore e njërës prej Shërbimeve të SMG-së).

Markat tregtare, logot dhe markat e shërbimeve ("Markat") të shfaqura në ose nëpërmjet Shërbimeve të SMG-së janë pronësi e SMG-së ose e palëve të treta. Juve nuk ju lejohet që të

përdorni Markat pa leje të mëparshme me shkrim të SMG-së ose ndonjë pale të tillë të tretë. Nëse doni informacion se si mund të merrni leje nga SMG-ja për të përdorur Përmbajtjen e SMG-së, na dërgoni email në [privacyofficer@smg.com](mailto:privacyofficer@smg.com).

## 5. PËRDORIMI I SHËRBIMEVE TË SMG-SË

- 5.1. **E Drejta:** Shërbimet e SMG-së nuk mund të përdoren nga fëmijët të cilët janë nën moshën ligjore në të cilën atyre u lejohet në vendin e tyre të banimit të japin miratimin e tyre për përpunimin e të dhënave të tyre personale. Nëse jeni nën moshën e miratimit në vendin tuaj, ju nuk mund t'i përdorini Shërbimet e SMG-së.
- 5.2. **Llogaria Juaj:** Juve mund t'ju kërkohet që të krijoni një llogari ("Llogaria") që të përdorni disa tipare të Shërbimeve të SMG-së. Ju bini dakord që të jepni, mbani dhe të përditësoni informacionin në mënyrë të saktë, aktuale dhe të plotë në lidhje me veten tuaj. Ju bini dakord që të mos pretendoni se jeni dikush tjetër apo entitet ose të falsifikoni identitetin tuaj apo lidhjen tuaj me ndonjë person apo entitet, duke përfshirë përdorimin e emrit të përdoruesit, fjalëkalimin apo informacione të tjera të llogarisë së një personi tjetër, ose emrin, ngjashmërinë, zërin, imazhin apo fotografinë e një personi tjetër. Për më tepër, ju bini dakord që të na njoftoni menjëherë në [privacyofficer@smg.com](mailto:privacyofficer@smg.com) për ndonjë përdorim të paautorizuar të emrit tuaj të përdoruesit, fjalëkalimit ose informacion tjetër të llogarisë, apo ndonjë shkelje tjetër të sigurisë për të cilën ju keni njohuri dhe që ka të bëjë me Shërbimet e SMG-së.

**Duke krijuar një Llogari, ju bini dakord që SMG-ja mund t'ju kontaktojë duke përdorur adresën e emailit që jepni kur aktivizoni Llogarinë tuaj.**

Mos lejoni persona të tjerë që të përdorin Llogarinë tuaj. Ju jeni përgjegjës për çdo përdorim të Llogarisë suaj, duke përfshirë ndonjë përdorim nga të tjerët të cilëve ju keni dhënë qasje në Llogarinë tuaj.

### 5.3. Përgjegjësitë Tuaja:

**Marrëveshja Juaj që të Përdorni Shërbimet e SMG-së Vetëm për Qëllime të Ligjshme.** Ju bini dakord se do të përdorni Shërbimet e SMG-së vetëm për qëllime të ligjshme. Ju nuk do t'i përdorni shërbimet e SMG-së në ndonjë mënyrë që mund të dëmtojë, çaktivizojë, mbingarkojë ose dëmtojë serverët ose rrjetet e SMG-së apo që ndërhyjnë me përdorimin dhe kënaqësinë e ndonjë pale tjetër të Shërbimeve të SMG-së.

**Marrëveshja juaj që të mos përdorni Shërbimet e SMG-së për qëllime të paautorizuara ose jo të ligjshme.** Për më tepër, ju bini dakord se nuk do të tentoni që të merrni qasje të paautorizuar të Shërbimeve të SMG-së, të Llogarive të përdoruesve të tjerë apo të sistemeve ose rrjeteve të kompjuterëve të SMG-së nëpërmjet piraterisë informatike, zbulimit të fjalëkalimeve ose ndonjë mjeti tjetër. Pa kufizuar atë që është thënë më sipër, ju bini dakord që nuk do të (dhe nuk do të nxitni ose lejoni palët e treta që):

- a. kopjoni, ndryshoni, përshtatni, përktheni, përdorni inxhinierinë e anasjelltë, dekodoni ose të bëni përpjekje të tjera që të merrni ose të fitoni qasje te ndonjë pjesë e Shërbimeve të SMG-së apo të Përmbajtjes së SMG-së;

- b. hiqni të drejtën e autorit, markës tregtare ose të drejtave të tjera të pronësisë që përmbahen në Shërbimet e SMG-së ose në Përmbajtjen e SMG-së;
- c. shmangni, çaktivizoni ose ndërhyjni me sigurinë- apo me tiparet që kanë të bëjnë me parandalimin e mashtrimit të Shërbimeve tona ose tipare të tjera që parandalojnë apo kufizojnë përdorimin ose të drejtën e autorit të ndonjë Përmbajtjeje të SMG-së apo zbatoni kufizime në përdorimin e Shërbimeve tona apo të Përmbajtjes së SMG-së;
- d. keqpërdorni Shërbimet duke futur me vetëdije viruse, Trojanë, krimba, bomba logjike, viruse spiunë, viruse keqdashëse dhe materiale të tjera keqdashëse apo të dëmshme teknologjike;
- e. përdorni ndonjë robot, merimangë, kërkim sajti/aplikacion rinxjerrës apo pajisje të tjera të automatizuara, përpunime ose mjete për qasje, rinxjerrje, gërvishetje apo indeksim të ndonjë pjesë të Shërbimeve të SMG-së;
- f. merrni me qira, jepni hua, shisni, nënlicenconi, caktoni, shpërndani, publikoni, transferoni ose i bëni të disponueshme Shërbimet e SMG-së, apo ndonjë tipar ose funksionaliteti të Shërbimeve të SMG-së, te një palë e tretë për ndonjë arsye, duke përfshirë vënien në dispozicion të Shërbimeve të SMG-së në një rrjet ku mund të përdoren nga më shumë se një pajisje në çdo kohë;
- g. riformatoni ose strukturoni ndonjë pjesë të faqeve të uebit që janë pjesë e Shërbimeve të SMG-së;
- h. krijoni më shumë se një Llogari duke përdorur mjete automatike apo me anë të pranisë false apo mashtruese; ose
- i. mblihdni apo ruani të dhëna personale për ndonjë përdorues tjetër pa miratimin e mëparshëm me shkrim prej tij.

**Pasoja për përdorimin e paautorizuar ose keqpërdorimin e Shërbimeve të SMG-së.**

Ju bini dakord se e drejta juaj për të përdorur Shërbimet e SMG-së do të humbasë menjëherë nëse shkelni ndonjë nga këto rregulla dhe se SMG-ja ka liri veprimi për të ndërprerë qasjen tuaj të Shërbimeve të SMG-së pa ndonjë njoftim të mëtejshëm nëse shkelni ndonjë nga kërkesat apo ndalimet e përcaktuara në këto Kushte ose në Kushtet e tjera të Zbatueshme. Gjithashtu, ju bini dakord që të ktheni ose shkatërroni ndonjë kopje të Materialeve të Sajtit që keni krijuar nëse ju kërkohet që ta bëni këtë.

Përdorimi i paautorizuar dhe keqpërdorimi i Shërbimeve të SMG-së janë rreptësisht të ndaluara; në varësi të rrethanave, ato mund t'ju bëjnë subjekt të një padie civile për dëmtime dhe/ose ndjekje penale. SMG-ja rezervon të drejtën për të raportuar ndonjë shkelje të këtyre Kushteve ose përdorimin e paautorizuar apo keqpërdorimin e Shërbimeve të SMG-së tek autoritetet e zbatimit të ligjit. Në rastin e ndonjë përdorimi të paautorizuar ose keqpërdorimit të Shërbimeve të SMG-së, e drejta juaj për të përdorur Shërbimet e SMG-së do të humbasë menjëherë dhe SMG-ja mund të ndërpresë qasjen tuaj te Shërbimet e SMG-së pa ndonjë njoftim.

**Përgjegjësia juaj për Pagesa, Tarifa dhe Kosto të Tjera në lidhje me Përdorimin e Shërbimeve të SMG-së (duke përfshirë Tarifat e Mesazheve me Tekst).** Ju jeni vetë përgjegjës për ndonjë dhe të gjitha pagesat, tarifat dhe kostot e tjera në lidhje me përdorimin e Shërbimeve të SMG-së. Nëse qasni dhe përdorni Shërbimet e SMG-së në smartphone, tablet ose pajisje të tjera celulare, duhet të keni shërbime pa tel nëpërmjet Wi-Fi ose një ofruesi shërbimi celular pjesëmarrës. Shërbime të veçanta mund të kërkojnë funksionalitetin e mesazhit me tekst (SMS ose MMS). Ju bini dakord se jeni vetë përgjegjës për të gjitha tarifat e mesazheve dhe të të dhënave që lindin nga ofruesi i shërbimit tuaj celular. Ne nuk imponojmë një tarifë të veçantë për ndonjë shërbim mesazhi me tekst që mund të ofrojmë, por mund të aplikohen tarifat e mesazhit dhe të të dhënave. Të gjitha tarifat faturohen dhe janë të pagueshme te ofruesi i shërbimit tuaj celular. Kontaktoni me ofruesin e shërbimit tuaj

celular për planet dhe detajet e çmimeve. SMG-ja nuk mban përgjegjësi për vonesa të mesazheve me tekst ose ndonjë dështim në dërgimin e mesazheve me tekst për shkak se dërgimi i mesazheve i nënshtrohet transmetimit efektiv nga ofruesi i shërbimit tuaj celular. Mesazhet me tekst mund të mos jenë në dispozicion në të gjitha zonat në çdo kohë.

**Pasojat e marrëveshjes suaj nëse zgjidhni të merrni mesazhe me tekst.** Pasi të zgjidhni që të merrni mesazhe me tekst nga ne, shpeshësia e mesazheve me tekst që ju dërgojmë do të varet nga transaksionet tuaja me ne. **Duke rënë dakord që të merrni mesazhe me tekst, ju kuptoni dhe bini dakord që SMG-ja mund të përdorë një sistem automatik të formimit të numrit për t'ju dërguar mesazhe me tekst, dhe gjithashtu kuptoni se pranimi juaj që të merrni mesazhe me tekst nuk është i detyrueshëm që të lejoheni të blini ndonjë mall apo shërbim.**

- 5.4. Parashtrimet. Herë pas here SMG-ja mund të ofrojë mundësi për ju dhe përdoruesit e tjerë që me dëshirë të postoni ose të paraqisni vlerësime, sugjerime, komente për video, ide, shënime, koncepte apo informacione ose materiale të tjera tek apo nëpërmjet Shërbimeve të SMG-së (së bashku, "**Parashtrimet**").

Ju jeni dhe do të vazhdoni të jeni vetë përgjegjës për Parashtrimet tuaja dhe për pasojat e parashtrimit dhe postimit të të tilla Parashtrimeve. Ju do të jeni vetë përgjegjës për ndonjë dëmtim që vjen nga ndonjë shkelje e të drejtave të autorit, të drejtave të pronësisë ose ndonjë dëm tjetër që vjen nga Parashtrimet tuaja. Kur parashtroni ose postoni Parashtrimet, ju duhet të kufizoni, sa më shumë që të jetë e mundur, sasinë e të dhënave personale që jepni, sepse Parashtrimet mund të lidhen me ju në varësi të detajeve që jepni.

Duke i dërguar, postuar ose transmetuar Parashtrimet SMG-së (dhe/ose tek i/të caktuari[t] ynë/tanë) apo në ndonjë zonë të Shërbimeve të SMG-së, ju automatikisht jepni ose garantoni se ju apo ndonjë pronar tjetër i materialit që parashtroni i jep plotësisht të drejtë, SMG-së dhe të caktuarve tanë në mbarë botën, të drejtë jo ekskluzive, të nënlicencueshme (me anë të niveleve të shumëfishta), të transferueshme, pa privilegje, të vazhdueshme, të pakthyeshme për të përdorur, prodhuar, nënlicencuar (me anë të niveleve të shumëfishta), shpërndarë, krijuar punë derivative, të kryejë dhe të importojë Parashtrimet tuaja (plotësisht apo pjesërisht) në ndonjë media të njohur tani ose të zhvilluar më vonë, për çfarëdo lloj qëllimi, tregtar ose tjetër, pa ndonjë kompensim për ju. Me fjalë të tjera, SMG-ja ka të drejtën automatike që të përdorë Parashtrimet tuaja – duke përfshirë riprodhimin, zbulimin, publikimin dhe transmetimin e Parashtrimet – në çdo vend, kohë, në çdo media ose për çdo qëllim pa paguar ndonjë tarifë apo pa patur ndonjë detyrim ndaj jush. Gjithashtu, ju lejoni ndonjë përdorues tjetër që të ketë qasje, paraqesë, të ruajë ose të riprodhojë Parashtrimin tuaj për përdorim personal nga ai përdorues. Ju i jepni SMG-së (dhe/ose të caktuarve tanë) të drejtën që të përdorë ndonjë prej Parashtrimeve tuaja për çdo lloj qëllimi në çdo vend. Në asnjë rrethanë ju nuk keni të drejtë për ndonjë lloj pagese nëse SMG-ja (dhe/ose i/të caktuari[t] i/e saj) përdor njërin prej Parashtrimeve tuaja. Të gjitha Parashtrimet konsiderohen jokonfidenciale dhe jopronësore.

Parashtrimet që ju postoni mund të vihen në dispozicion të publikut. Ju pranoni se nuk keni pritje të privatësisë në lidhje me ndonjë nga Parashtrimet tuaja. Gjithashtu, pranoni se i bëni Parashtrimet me dëshirë dhe merrni përsipër rrezikun që lidhet me to. Ju duhet të përdorni gjykimin e shëndoshë kur postoni informacion, vërejtje ose përmbajtje të tjera në lidhje me SMG-në, Klientët e SMG-së apo ndonjë entitet ose person tjetër. Ju mund të mbani përgjegjësi ligjore për dëmtime të shkaktuara ndaj përdoruesve të tjerë, SMG-së ose palëve të treta si rezultat i shpifjeve apo Parashtrimeve tuaja që çojnë në veprime ligjore.

Kur postoni një Parashtrim, ju mund të zgjidhni që të lidhni Parashtrimin me emrin tuaj të përdoruesit ose pseudonimin me përjashtim të rastit kur ligjet e zbatueshme në vendin tuaj të banimit nuk e lejojnë një gjë të tillë.

SMG-ja nuk mban përgjegjësi ligjore për ndonjë Parashtrim të bërë nga përdoruesit edhe nëse Parashtrime të tilla janë shpifëse apo çojnë në veprime ligjore . SMG-ja nuk mban përgjegjësi dhe nuk mbështet, opinione, këshilla apo rekomandime të postuara ose të paraqitura te ose nëpërmjet Shërbimeve të SMG-së. SMG-ja hedh poshtë në mënyrë të veçantë të gjitha përgjegjësitë që kanë të bëjnë me Parashtrime të tilla. SMG-ja nuk konfirmon ose verifikon kualifikimet, prejardhjen apo aftësitë e përdoruesve ose informacionin që ata postojnë te ose nëpërmjet Shërbimeve të SMG-së. Prandaj, SMG-ja ju nxit që të përdorni gjykimin e shëndoshë në përgatitjen e Parashtrimit tuaj.

Duke postuar një Parashtrim, ju bini dakord, përfaqësoni dhe garantoni se Parashtrimi:

- a. është i vërtetë dhe i saktë;
- b. i përket një subjekti ose temë të caktuar të Shërbimeve të SMG-së;
- c. nuk ndërhyr, keqpërdor ose shkel ndonjë të drejtë të autorit, markë tregtare, patentë, sekret letrar, sekret tregtar, privatësi, publicitet, pronësi, kontraktuale ose të drejta të tjera të palës së tretë;
- d. nuk përmban informacion që identifikon një person ose informacion që në raste të tjera përfshin të dhëna personale të një personi përveçse nëse keni miratim të mëparshëm me shkrim nga personi;
- e. nuk bën akuza pa bazë në lidhje me ndonjë palë të tretë ose produktet apo shërbimet e saj;
- f. nuk përmban komente ofenduese, shpifëse, përgojuese, të rreme, të gabuara, vulgare, të pahijshme, pornografike, të dhunshme, fanatike, të qarta seksuale, me urrejtje, abusive, kërcënuese, ngacmuese, josociale, seksuale ose raciale apo ndonjë koment tjetër që dëmton ose mendohet se mund të dëmtojë ndonjë person ose entitet;
- g. nuk është i paligjshëm dhe nuk inkurajon ose nxit aktivitete të paligjshme apo diskutimin e aktiviteteve të paligjshme duke patur si qëllim kryerjen e tyre;
- h. nuk është i lidhur me tregtinë ose biznesin dhe nuk reklamon apo ofron që të shesë produkte apo shërbime (pavarësisht nëse janë për qëllime fitimi ose jo), ose të kërkojë nga të tjerët (duke përfshirë kërkesën për dhurime dhe kontribute);
- i. nuk përmban një virus ose përbërës tjetër të dëmshëm, apo pjesë të ngacmuara, të keqësuar ose të prishura të Shërbimeve të SMG-së apo ndonjë rrjeti të lidhur ose që ndërhyr me përdorimin e entitetit të ndonjë personi ose gëzimin e Shërbimeve të SMG-së; dhe
- j. përputhet me të gjitha ligjet, rregulloret, rregullat, dhe politikat e kushtet kontraktuale që i përkasin Parashtrimit tuaj, si dhe Shërbimeve të SMG-së te të cilat ose nëpërmjet të cilave ju po postoni ose jepni Parashtrimin tuaj, duke përfshirë kufizimet e moshës.

Ju pranoni dhe bini dakord se SMG-ja ka të drejtën, por jo detyrimin, që të ndryshojë, heqë ose të refuzojë të postojë ose të lejojë të postohet ndonjë Parashtrim. SMG-ja nuk mban përgjegjësi dhe nuk merr përsipër ndonjë detyrim për ndonjë Parashtrim të postuar nga ju ose ndonjë palë e tretë. SMG-ja nuk mund të sigurojë dhe nuk siguron se të gjithë përdoruesit po i zbatojnë këto dispozita dhe, midis jush dhe SMG-së, ju merrni përsipër të gjitha rreziqet e dëmtimit ose lëndimit që rezultojnë nga mospajtimi me këto dispozita.

SMG-ja ju nxit shumë që të zvogëloni zbulimin e të dhënave personale në Parashtrimet tuaja sepse personat e tjerë mund t'i shikojnë dhe t'i përdorin të dhënat personale në

Parashtrimet tuaja. SMG-ja nuk mban përgjegjësi për informacionin që ju vendosni të komunikoni nëpërmjet Parashtrimeve.

## **6. SAJTET DHE SHËRBIMET E PALËVE TË TRETA**

Shërbimet e SMG-së mund të përmbajnë lidhje me sajtet e uebit dhe shërbimet e palëve të treta, duke përfshirë median sociale (së bashku, “**Shërbimet e Lidhura**”). Shërbimet e Lidhura nuk janë nën kontrollin e SMG-së dhe SMG-ja nuk mban përgjegjësi për Shërbimet e Lidhura apo për ndonjë informacion ose material në to, ose ndonjë formë transmetimi të marrë nga ndonjë Shërbim i Lidhur. Përfshirja e një lidhjeje nuk nënkupton mbështetjen nga SMG-ja të Shërbimeve të Lidhura ose ndonjë bashkëpunim me operuesit e Shërbimit të Lidhur. SMG-ja nuk heton, verifikon ose monitoron Shërbimet e Lidhura. SMG-ja ofron lidhje me Shërbimet e Lidhura vetëm për lehtësinë tuaj. Ju qaseni në Shërbimet e Lidhura duke marrë vetë përsipër rrezikun.

## **7. VLEFSHMËRIA E KONTRATËS, MOSPRANIMI I GARANCIVE DHE KUFIZIMET E DETYRIMIT**

SMG-ja garanton se ajo ka hyrë në mënyrë të vlefshme në këto Kushte dhe ka fuqinë ligjore për ta bërë këtë. Ju garantoni se keni hyrë në mënyrë të vlefshme në këto Kushte dhe keni fuqinë ligjore për ta bërë këtë.

### **ME PËRJASHTIM TË RASTEVE TË PARAQITURA QARTËSISHT MË SIPËR, SHËRBIMET E SMG-SË JEPEN “SIÇ JANË” DHE “SIÇ JANË NË DISPOZICION” PA GARANCI TË NDONJË LLOJI, TË SHPREHUR OSE TË NËNKUPTUAR.**

SMG-ja nuk përfaqëson ose garanton në lidhje me saktësinë, besueshmërinë, plotësinë apo leverdishmërinë e Përmbajtjes së SMG-së ose të rezultateve që mund të merren duke përdorur Shërbimet e SMG-së dhe Përmbajtjen e SMG-së. Ju i përdorni Shërbimet dhe Përmbajtjen e SMG-së duke marrë vetë përsipër rrezikun. Shërbimeve të SMG-së dhe Përmbajtjes së SMG-së u bëhen ndryshime herë pas here. Këto ndryshime mund të bëhen në çdo kohë. Një pjesë e përmbajtjes së Shërbimeve të SMG-së mund të ofrohen nga palët e treta. SMG-ja nuk mban përgjegjësi ndaj palëve të treta për ndonjë përmbajtje të tillë.

SHËRBIMET E SMG-SË DHE PËRMBAJTJA E SMG-SË JEPEN MBI BAZËN “SIÇ JANË” PA NDONJË GARANCI TË NDONJË LLOJI. DERI NË MASËN E LEJUAR NGA LIGJI I ZBATUESHËM, SMG-JA HEQ DORË SPECIFIKISHT NGA TË GJITHA GARANCITË DHE KUSHTET E ÇDO LLOJI, DUKE PËRFSHIRË TË GJITHA GARANCITË DHE KUSHTET E NËNKUPTUARA TË AFTËSISË SË TREGTIMIT, USHTRIMIT PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR, TITULLIT, MOS-SHKELJES SË TË DREJTAVE PRONËSORE TË PALËS SË TRETË, LIRISË NGA DEFECTET, PËRDORIMIT TË PANDËRPRERË DHE TË GJITHA GARANCITË E NËNKUPTUARA NGA NDONJË RRJEDHË E TË MARRURIT APO PËRDORIMIT TË TREGTISË.

SMG-JA NUK GARANTON QË (A) SHËRBIMET E SMG-SË DO TË PËRMBUSHIN KËRKESAT TUAJA, (B) FUNKSIONIMI I SHËRBIMEVE TË SMG-SË DO TË JETË I PANDËRPRERË OSE VIRUS- APO PA GABIME OSE (C) GABIMET DO TË KORRIGJOHEN. NËSE PËRDORIMI JUAJ I SHËRBIMEVE TË SMG-SË OSE I PËRMBAJTJES SË SMG-SË REZULTON NË NEVOJË PËR MIRËMBAJTJE OSE ZËVENDËSIM TË PAJISJES, APO NË

HUMBJE TË PËRFITIMEVE OSE TË TË DHËNAVE, SMG-JA NUK MBAN PËRGJEGJËSI PËR KËTO KOSTO. ÇDO KËSHILLË VERBALE OSE ME SHKRIM E DHËNË NGA SMG-JA APO NGA AGJENTËT E SAJ TË AUTORIZUAR NUK ËSHTË DHE NUK DO TË KRIJOJË NJË GARANCI. DISA JURIDIKSIONE NUK LEJOJNË PËRJASHTIMIN E GARANCIVE TË NËNKUPTUARA QË DO TË THOTË SE DISA PREJ PËRJASHTIMEVE OSE TË GJITHA PËRJASHTIMET E MËSIPËRME MUND TË MOS JENË TË ZBATUESHME NË RASTIN TUAJ.

**PËRDORIMI NGA ANA JUAJ E SHËRBIMEVE TË SMG-SË BËHET DUKE MARRË VETË PËRSIPËR RREZIKUN.** Nëse jeni të pakënaqur me Shërbimet e SMG-së, duke përfshirë ndonjë përmbajtje të Shërbimeve të SMG-së, e vetmja zgjidhje është që të ndërpriten përdorimin e Shërbimeve të SMG-së.

JU BINI DAKORD SE NË ASNJË RAST SMG-JA OSE NDONJË PALË E TRETË E PËRMENDUR NË SHËRBIMET E SMG-SË NUK MBAN PËRGJEGJËSI (A) PËR DËMTIME TË NDONJË LLOJI, DUKE PËRFSHIRË DËMTIME TË DREJTPËRDREJTA, JO TË DREJTPËRDREJTA, TË VEÇANTA, SHEMBULLORE, TË RASTËSISHME, ME PASOJA NDËSHKUESE APO NDONJË LLOJ TJETËR DËMI (DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR ME BLERJEN E MALLRAVE APO SHËRBIMEVE ZËVENDËSUESE, HUMBJEN E PËRDORIMIT, TË TË DHËNAVE OSE PËRFITIMEVE, APO NDËRPRERJEN E BIZNESIT), PAVARËSISHT NGA MËNYRA SE SI SHKAKTOHEN DHE NË BAZË TË ÇDO TEORIE TË PËRGJEGJËSISË QË DEL NGA LIDHJA ME KËTO KUSHTE, ME PËRDORIMIN APO PAAFTËSINË PËR TË PËRDORUR SHËRBIMET E SMG-SË DHE PËRMBAJTJEN E TYRE, NËSE BAZOHET NË GARANCI, KONTRATË, PËRGJEGJËSI, OFENDIM (DUKE PËRFSHIRË PAKUJDESI OSE DIÇKA TË TILLË), OSE NDONJË TEORI TJETËR LIGJORE EDHE NËSE SMG-JA ËSHTË KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E NJË DËMTIMI TË TILLË, OSE (B) PËR NDONJË KËRKESË, PRETENDIM APO DËMTIM TJETËR, CILIDO QË REZULTON OSE KA LIDHJE ME PËRDORIMIN TUAJ TË SHËRBIMEVE TË SMG-SË. KY MOHIM I PËRGJEGJËSISË NUK GJEN ZBATIM NË PËRGJEGJËSITË QË REZULTOJNË NGA PAKUJDESIA JONË E RËNDË OSE SJELLJA E KEQE ME DIJENI, DHE NUK GJEN ZBATIM DERI NË MASËN E NDALUAR NGA LIGJI NË ZBATIM.

NËSE PËR NDONJË ARSYE MOHIMI I GARANCIVE OSE KUFIZIMET E PËRGJEGJËSIVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SEKSION 7 ËSHTË/JANË TË PAAPLIKUESHME OSE TË PAZBATUESHME PËR NDONJË ARSYE, PËRGJEGJËSIA MAKSIMALE E SMG-SË PËR ÇDO LLOJ DËMTIMI DO TË JETË E KUFIZUAR DERI NË MASËN 1000\$.

**Ju pranoni dhe bini dakord se kufizimet e përgjegjësive të dhëna më sipër, së bashku me dispozitat e tjera të dhëna në këto Kushte që kufizojnë përgjegjësinë, janë kushte të rëndësishme dhe që SMG-ja nuk do të ketë vullnetin që t'ju japë juve të drejtat e përcaktuara në këto Kushte nëse nuk bini dakord me kufizimet e përgjegjësive të përcaktuara.**

NËSE JENI BANOR I KALIFORNISË, JU HIQNI DORË NGA TË DREJTAT TUAJA NË LIDHJE ME SEKSIONIN 1542 TË KODIT CIVIL TË KALIFORNISË, I CILI THOTË SE "NJË LIRIM I PËRGJITHSHËM NUK PËRFSHIN KËRKESAT TË CILAT KREDITORI NUK I DI OSE DYSHON SE EKZISTOJNË NË FAVORIN E TIJ NË MOMENTIN E EKZEKUTIMIT TË LIRIMIT, I CILI, NËSE NJIHET PREJ TIJ, DUHET TË KETË NDIKUAR MATERIALISHT MARRËVESHJEN E TIJ ME DEBITORIN."

## **8. DËMSHPËRBLIMI**

Ju bini dakord që, me shpenzimet tuaja, të mbron, dëmshpërbleni dhe të mos dëmtoni SMG-në dhe klientët e saj, drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe agjentët nga dhe kundër të gjitha humbjeve,



përgjegjësi, pretendimeve, veprimeve ose kërkesave, duke përfshirë por pa u kufizuar në, dëme në para, shpenzime, kosto të mbrojtjes, duke përfshirë pagesa të arsyeshme të avokatit dhe të kontabilitetit, të bëra kundër SMG-së nga ndonjë palë e tretë të shkaktuara nga (a) Parashtrimet tuaja, (b) përdorimi juaj i Shërbimeve të SMG-së ose (c) shkëlja nga ana juaj e ndonjërit prej këtyre Kushteve, të drejtave të një pale të tretë apo ligjit në zbatim. Kjo dispozitë e dëmshpërblimit nuk aplikohet deri në masën që ndalohet nga ligji në zbatim. SMG-ja ruan të drejtën që, me shpenzimet e veta, të marrë mbrojtjen e veçantë dhe kontrollin e çdo çështjeje që i nështrohet dëmshpërblimit në fjalë. Asnjë zgjidhje që ndikon në të drejtat dhe detyrimet e SMG-së nuk mund të bëhet pa miratimin e mëparshëm me shkrim nga SMG-ja.

## **9. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Me përjashtim të mosmarrëveshjeve në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e pronësisë intelektuale, ose ndonjë pretendimi për shkëlje, i cili do të drejtohet sipas ligjeve federale të SHBA-së, të gjitha mosmarrëveshjet midis jush dhe SMG-së që lindin nga ose kanë të bëjnë me Kushtet, do të drejtohen dhe interpretohen e zbatohen në përputhje me ligjet e Shtetit të Mizurit (Shtetet e Bashkuara) pavarësisht nga vendi juaj i origjinës apo se ku qasni Shërbimet dhe pavarësisht nga ndonjë konflikt me parimet ligjore. Të gjitha mosmarrëveshjet e tilla do të interpretohen në përputhje me ligjet e Mizurit të zbatueshme për kontratat e lidhura dhe të zbatuara brenda Shtetit të Mizurit. Ju dhe SMG-ja bini dakord se Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave nuk gjen zbatim në interpretimin apo krijimin e këtyre Kushteve.

**JU DHE SMG-JA BINI DAKORD QË SECILA PALË MUND TË NGREJË PRETENDIME KUNDËR NJËRA-TJETRËS VETËM NË NJË BAZË INDIVIDUALE DHE JO SI NJË PADITËS APO ANËTAR I KLASËS NË ÇDO KLASË TË SUPOZUAR OSE VEPRIME TË PËRFAQËSUARA APO NDJEKJE.**

**JU DHE SMG-JA BINI DAKORD QË TË GJITHA PRETENDIMET DO TË ZGJIDHEN ME ANË TË ARBITRAZHIT NË BAZË TË SEKSIONIT 9 DHE SE JU DHE SMG-JA HIQNI DORË NGA E DREJTA QË T'I NGRINI KËTO PRETENDIME PARA GJYKATËS LIGJORE. TË DREJTAT QË DO TË KISHIT NËSE DO TË SHKONIT NË GJYKATË, TË TILLA SI QASJE NË ZBULIM, MUND TË MOS JENË NË DISPOZICION OSE TË JENË TË KUFIZUARA NË ARBITRAZH.**

Çdo mosmarrëveshje midis jush dhe SMG-së e agjentëve të saj, punonjësve, zyrtarëve, drejtorëve, drejtuesve, pasuesve, të caktuarve, filialeve ose bashkëpunëtorëve që lindin nga ose kanë të bëjnë me këto Kushte dhe interpretimin e tyre apo prishja, përfundimi ose vlera e tyre, marrëdhëniet që rezultojnë nga këto Kushte, duke përfshirë mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë, qëllimin ose vënien në zbatim të këtyre Kushteve në arbitrazh (së bashku, "**Mosmarrëveshjet e Mbuluara**") do t'i nënshtrohen arbitrazhit detyrues në Shtetin e Mizurit të administruar nga Shoqata Amerikane e Arbitrazhit (AAA) në përputhje me rregullat e saj (duke përfshirë rregullat dhe procedura e saj për mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me konsumatorin) në fuqi në datën në fjalë. Para se të filloni një proces arbitrazhi, pala nismëtare do t'i japë palës tjetër njoftim paraprak me shkrim të paktën 60 ditë më parë për qëllimet e saj për nisjen e arbitrazhit. SMG-ja do të japë një njoftim të tillë me anë të emailit tek adresa e emailit që keni ofruar kur keni krijuar llogarinë tuaj ose me email tek adresa e emailit që ju mund t'i keni dhënë SMG-së; duhet t'ia jepni një njoftim të tillë SMG-së me email në [privacyofficer@smg.com](mailto:privacyofficer@smg.com).

Pagesat për të gjitha dokumentet e dorëzuara, administrimin dhe tarifat e arbitruerit do të drejtohen nga rregullat e AAA-së. Megjithatë, nëse ju jeni në gjendje që të tregoni se kostot e arbitrazhit do të jenë një pengesë për ju në krahasim me koston e çështjes gjyqësore, SMG-ja do të paguajë atë pjesë të pagesës së dorëzimit të dokumenteve, administrimit dhe arbitrazhit

që arbitruesi e shikon të arsyeshme për të parandaluar që arbitrazhi të bëhet ndalues kostoje për ju. Nëse arbitruesi vendos se pretendimi(et) që sollët për arbitrazh është/janë i/të pavlerë/a, ju bini dakord që të kompensoni SMG-në për të gjitha pagesat në lidhje me arbitrazhin që SMG-ja ka paguar për ju të cilat ishit të detyruar t'i paguanit sipas rregullave të AAA-së.

Arbitruesi do të përzgjidhet në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit Tregtar të AAA-së. Arbitrazhi do të zhvillohet në gjuhën angleze. Arbitruesi do të ketë fuqinë për të akorduar çdo lloj ndihme që është në dispozicion të gjykatës në bazë të ligjit ose në paanësi dhe çdo vendim i arbitrit do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për çdo palë dhe mund të futet si gjykim në çdo gjykatë të juridiksionit kompetent. Megjithatë, arbitri nuk do të ketë fuqinë për të akorduar dëmtime ndëshkuese ose shembullore, e drejtë nga e cila çdo palë heq dorë. Arbitruesi do të zbatojë ligjet e zbatueshme dhe kërkesat e këtyre Kushteve; dështimi për ta bërë këtë do të konsiderohet një tejkalim i autoritetit arbitrues dhe bazë për shqyrtim gjyqësor. Vendimi i arbitruesit duhet të jetë një shpjegim me shkrim dhe duhet të mbetet konfidencial. SMG-ja dhe ju bini dakord se çdo Mosmarrëveshje e Mbuluar do të parashtrohet për arbitrazh vetëm në bazë individuale. **AS SMG-JA DHE AS JU NUK KENI TË DREJTË TË ARBITRONI NJË MOSMARRËVESHJE TË MBULUAR SI NJË KLASË, PËRFAQËSUES OSE VEPRIM PRIVAT I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ARBITRUESI NUK DO TË KETË AUTORITET PËR TË VAZHDUAR MË TEJ NË BAZË TË KLASËS, PËRFAQËSUESIT OSE BAZËS PRIVATE TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM.** Nëse ndonjë dispozitë e marrëveshjes për të arbitruar në Seksionin 9 nuk mund të zbatohet, dispozita që nuk mund të zbatohet do të hiqet dhe do të zbatohen kushtet e mbetura të arbitrazhit (por në asnjë rast nuk do të ketë arbitrazh të një klase, përfaqësuesi ose prokurori të përgjithshëm privat). Pavarësisht nga ndonjë statut ose ligj në kundërshtim, njoftimi për çdo pretendim që ngrihet ose ka të bëjë me këto Kushte, duhet të bëhet brenda një (1) viti pasi të ketë lindur një pretendim i tillë ose pretendimi do të konsiderohet i mbyllur përgjithmonë. Për qëllime të këtij Seksioni 9, këto Kushte dhe transaksionet e lidhura do t'i nënshtrohen dhe do të drejtohen nga Akti Federal i Arbitrazhit, 9 U.S.C. sek. 1-16 (FAA).

**Shënim:** Duke rënë dakord me këto Kushte, ju bini dakord shprehimisht se çdo çështje ose veprim që mund të ndërmerri kundër SMG-së sipas ligjeve të çdo juridiksioni jashtë Shteteve të Bashkuara nuk merret parasysh, duke përfshirë pa kufizim, ndonjë kërkesë ose veprim sipas ligjeve të vetë vendit tuaj dhe se vendi i vetëm dhe ligjet e zbatueshme për ndonjë mosmarrëveshje është në Shtetet e Bashkuara sipas kushteve të Seksionit 9.

## 10. SHPËRBLIMET

Herë pas here, SMG-ja mund të ofrojë mundësi për të marrë shpërblime, si pikë shpërblimi, zbritje ose oferta speciale (së bashku, "Shpërblimet"). Ne do t'ju njoftojmë kur Shpërblimet të jenë në dispozicionin tuaj nëpërmjet Shërbimeve të SMG-së. Përfitimi i Shpërblimit mund të ndryshojë ashtu si mund të ndryshojë edhe periudha e vlefshmërisë, prandaj kontrolloni detajet e çdo Shpërblimi kur ta merrni. Për SurveyMini, pas nëntëdhjetë (90) ditësh pa aktivitet, pikët e shpërblimit do të skadojnë. Shpërblimet tuaja janë për përdorim personal. Nuk mund t'i transferoni, caktoni, shisni, tregtoni ose t'i shkëmbeni Shpërblimet tuaja. Me përjashtim të rastit kur kërkohet nga ligji, Shpërblimet nuk kthehen në para dhe nuk mund të kombinohen me ndonjë promovim tjetër të SMG-së ose klientit, ofertë apo zbritje tjetër. Nuk do të jepen kredite ose rimbursime për ndonjë arsye pasi t'i përdorni Shpërblimet tuaja. SMG-ja ka të drejtë të ndryshojë, ndërpresë ose pezullojë disponueshmërinë e Shpërblimeve. Ju bini dakord që t'i bindeni vendimeve të SMG-së, të cilat janë përfundimtare dhe të detyrueshme në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Shpërblimet.

## **11. PËRDITËSIMET E APLIKACIONEVE CELULARE**

Herë pas here ju (me lirinë tuaj të plotë) mund të zhvilloni dhe siguronit përditësime për aplikacionet tona celulare, të cilat mund të përfshijnë përmirësime, rregullime të defekteve, arrime dhe korrigjime të tjera gabimesh dhe/ose tipare të reja (së bashku, “Përditësimet”). Gjithashtu, përditësimet mund të ndryshojnë ose fshijnë në tërësinë e tyre disa tipare dhe funksionalitete të caktuara. Ju bini dakord se SMG-ja nuk ka ndonjë detyrim për të siguruar ndonjë Përditësim ose të vazhdojë t’ju sigurojë ose mundësojë ndonjë tipar apo funksionalitet të caktuar.

Në bazë të parametrave të pajisjes suaj celulare, kur pajisja juaj celulare lidhet me Internetin ose: (a) Përditësimet do të shkarkohen automatikisht dhe do të instalohen; ose (b) mund të merrni njoftim apo të nxiteni të shkarkoni dhe instaloni Përditësimet në dispozicion.

Shkarkoni dhe instaloni menjëherë të gjitha Përditësimet. Nëse nuk e bëni një gjë të tillë, disa pjesë të Shërbimeve të SMG-së mund të mos funksionojnë si duhet. Gjithashtu, ju bini dakord që të gjitha Përditësimet do të konsiderohen pjesë e Shërbimeve të SMG-së dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të përgjithshme të këtyre Kushteve.

## **12. KONTRAKTIMI ELEKTRONIK**

Veprimi juaj pohues i përdorimit dhe/ose i regjistrimit për Shërbimet e SMG-së përbën miratimin tuaj për të hyrë elektronikisht në marrëveshje me ne.

## **13. KUFIZIMET GJEOGRAFIKE/KONTROLLET E EKSPORTIT**

Shërbimet e SMG-së dhe Përmbajtja e SMG-së e kanë bazën në Shtetin e Mizurit në Shtetet e Bashkuara dhe megjithëse secila mund të sigurojë qasje dhe të përdoret nga personat e vendosur jashtë Shteteve të Bashkuara, ju pranoni se për arsye ligjore dhe funksionale mund të mos keni qasje në Shërbimet e SMG-së ose në Përmbajtjen e SMG-së në juridiksionin tuaj. Nëse qasni Shërbimet e SMG-së dhe Përmbajtjen e SMG-së jashtë Shteteve të Bashkuara, ju jeni përgjegjës që të pajtoheni me ligjet lokale, duke përfshirë ligjet lokale në lidhje me importin, eksportin ose ri-eksportin e Përmbajtjes së SMG-së.

Shërbimet e SMG-së mund t’i nënshtrohen ligjeve të kontrollit të eksportit në disa vende të caktuara, duke përfshirë Aktin e Administrimit të Eksportit të SHBA-së dhe rregullat që lidhen me të. Ju bini dakord që të pajtoheni me ligje dhe rregulla të tilla, dhe se nuk do të eksportoni, ri-eksportoni ose të lëshoni Shërbimet e SMG-së, drejtpërdrejt apo jo-drejtpërdrejt, që t’i bëni Shërbimet e SMG-së të qasshme nga çdo juridiksion ose vend në të cilin eksporti, ri-eksportimi ose lëshimi është i ndaluar me ligj, rregulla ose rregullore. Gjithashtu, ju bini dakord se do të pajtoheni me të gjitha ligjet federale, rregullat dhe rregulloret e zbatueshme, dhe të përmbushni të gjitha sipërmarrjet e kërkuara (duke përfshirë marrjen e ndonjë licence të nevojshme eksportimi ose ndonjë miratim tjetër qeveritar), para eksportimit, ri-eksportimit ose më fjalë të tjera t’i bëni Shërbimet e SMG-së të disponueshme jashtë Shteteve të Bashkuara. Për më tepër, duke shkarkuar Përmbajtjen e SMG-së, ju bini dakord se nuk jeni në një vend në të cilin një shkarkim i tillë është i ndaluar dhe që nuk jeni në Shtetet e Bashkuara. Tabela e Departamentit të Tregtisë për Mohimin e Porosive ose të Shteteve të Bashkuara Lista e Departamentit të Thesarit për Shtetasit e Caktuar Posaçërisht.

## **14. TË DREJTAT E QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA**

Shërbimet e SMG-së janë softuerë kompjuterikë tregtarë, siç përcaktohet në 48 C.F.R. §2.101. Prandaj, nëse jeni një agjenci e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara ose një kontraktues, ju merrni vetëm ato të drejta që kanë të bëjnë me Shërbimet e SMG-së siç u garantohen të gjithë përdoruesve të tjerë në bazë të licencës, në përputhje me (a) 48 C.F.R. §227.7201 deri në 48

C.F.R. §227.7204, në lidhje me Departamentin e Mbrojtjes dhe kontraktuesve të tyre, apo (b) 48 C.F.R. §12.212, në lidhje me të gjithë të licencuarit e tjerë të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe kontraktuesve të tyre.

## 15. NDËRPRERJA

Me lirinë e saj të veprimit, SMG-ja mund të ndryshojë ose të ndërpresë Shërbimet e SMG-së, apo të ndryshojë, pezullojë ose të mbyllë llogarinë tuaj apo qasjen në Shërbimet e SMG-së, me ose pa njoftim ndaj jush, në çdo kohë dhe për çdo arsye, pa ndonjë përgjegjësi ndaj jush ose ndonjë pale të tretë. Për shembull, Llogaria juaj mund të mbyllet dhe qasja në Shërbimet e SMG-së të mohohet, me ose pa njoftim, nëse SMG-ja ka arsye të besojë se jeni i mitur. Si një shembull tjetër, SMG-ja mund ta mbyllë llogarinë tuaj dhe aftësinë tuaj për të përdorur Shërbimet e SMG-së, me ose pa njoftim, nëse SMG-ja beson se ju keni dhënë informacion jo të vërtetë, jo të plotë ose të pasaktë apo me fjalë të tjera keni dështuar të pajtoheni me këto Kushte ose me Kushtet Shtesë që gjejnë zbatim.

Ju bini dakord që të ktheni dhe të shkatërroni çdo kopje të ndonjë Materiali të Sajtit që mund të keni bërë nëse ju kërkohet një gjë të tillë.

Ndërprerja nuk do t'i kufizojë të drejtat apo korrigjimet e tjera të SMG-së. Këto Kushte qartësisht mbijetojnë dhe do të vazhdojnë të jenë në fuqi, pavarësisht nga ndryshime, ndërprerje, pezullime dhe/ose mbyllje të tilla.

## 16. PRETENDIMET E SHKELJES SË TË DREJTËS SË AUTORIT

SMG-ja respekton të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të tjerëve. Ne u përgjigjemi njoftimeve për shkelje të mundshme siç kërkohet nga Akti Mijëvjeçar Dixhital i të Drejtës së Autorit të Shteteve të Bashkuara ("**DMCA**"), duke përfshirë, ku shihet e arsyeshme, largimin dhe çaktivizimin e qasjes ndaj materialeve të cilat i nënshtrohen aktivitetit shkelës.

Nëse me të vërtetë besoni se puna juaj është kopjuar në një mënyrë që përbën shkelje të së drejtës së autorit ose nëse të drejtat tuaja të pronësisë intelektuale janë shkelur në ose nëpërmjet Shërbimeve të SMG-së, dërgoni kërkesën ose njoftimin tuaj të shkeljes tek agjenti i DMCA-së duke e postuar te:

DMCA Agent  
Service Management Group, LLC  
1737 McGee Street  
Kansas City, MO 64108

Ose email:

[privacyofficer@smg.com](mailto:privacyofficer@smg.com)

Njoftimi juaj duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- a. nënshkrim fizik ose elektronik të një personi të autorizuar për të vepruar në emër të pronarit, e drejta e të cilit mendohet se është shkelur;
- b. identifikim të veprës që mban të drejtën e autorit për të cilën bëhet kërkesa për shkelje ose, nëse disa vepra që mbajnë të drejtën e autorit në një vend të vetëm në internet që

mbulohen vetëm nga një njoftim, një listë përfaqësuese e punëve të tilla në atë vendndodhje;

- c. identifikim të materialit që pretendohet se është shkelur ose që i nënshtrohet aktivitetit shkelës dhe që duhet të largohet apo qasja tek materiali duhet të çaktivizohet, dhe informacion i mjaftueshëm në mënyrë të arsyeshme për t'i lejuar ofruesit të shërbimit që të gjejë vendndodhjen e materialit;
- d. informacion i mjaftueshëm në mënyrë të arsyeshme për të lejuar ofruesin e shërbimit që të kontaktojë me palën që bën ankesën, të tilla si adresa, numri i telefonit dhe nëse e mundshme, një adresë postare elektronike në të cilën pala që bën ankesën mund të kontaktohet;
- e. një deklaratë që pala që bën ankesën ka besim se përdorimi i materialit siç përshkruhet në ankesë nuk autorizohet nga pronari i të drejtës së autorit, agjenti i tij ose ligji; dhe
- f. një deklaratë se informacioni në njoftim është i saktë, dhe se në bazë të ndëshkimit për deklaratë të rreme, pala ankuese është e autorizuar të veprojë në emër të pronarit, e drejta e të cilit mendohet se është shkelur.

Agjenti ynë i DMCA-së vetëm do t'i përgjigjet njoftimeve dhe kërkesave që pajtohen me kërkesat e DMCA-së. Shikoni [www.copyright.gov](http://www.copyright.gov) për më tepër informacion.

## 17. INFORMACION PËR BANORËT E KALIFORNISË

Në bazë të Seksionit 1789.3 të Kodit Civil të Kalifornisë, na kërkohet që t'u japim banorëve të Kalifornisë informacionin specifik në vijim që ka të bëjë me të drejtat e konsumatorit:

- a. Shërbimet e SMG-së janë pronë dhe/ose operohen nga Service Management Group, LLC, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108. Numri i kontaktit me telefon për SMG-në është 1-800-764-0439;
- b. Përveçse kur thuhet shprehimisht ndryshe, Shërbimet e SMG-së jepen pa ndonjë pagesë;
- c. që të bëni një ankesë në lidhje me Shërbimet e SMG-së ose që të merrni informacion të mëtejshëm në lidhje me përdorimin e Shërbimeve të SMG-së, dërgoni një letër te Service Management Group, LLC, Për: Data Protection Officer, 1737 McGee Street, Kansas City, MO 64108 ose na kontaktoni me email te [privacyofficer@smg.com](mailto:privacyofficer@smg.com) (me "California Resident Request (Kërkesë nga Banori i Kalifornisë)" në rreshtin e Temës). Gjithashtu, ju mund të kontaktoni me Njësinë e Ndihmës për Ankesa (Complaint Assistance Unit) të Divizionit të Shërbimit të Konsumatorit të Departamentit të Çështjeve të Konsumatorit për Kaliforninë (Division of Consumer Services of California's Department of Consumer Affairs) me shkrim në 400 R Street, Suite 1080, Sacramento, California 95814 ose me telefon në 916.445.1254 apo 800.952.5210.

## 18. TË NDRYSHME

- a. Këto Kushte dhe politikat e privatësisë të listuara në sajtet përkatëse përmbajnë mirëkuptimin e plotë nga dhe midis SMG-së e ju në lidhje me çështjet e përmendura në këtë dokument.
- b. Këto Kushte janë shkruar në anglisht. Kjo Marrëveshje në gjuhën angleze do të jetë kontrolluese në të gjitha aspektet. Çdo version i kësaj Marrëveshjeje në ndonjë gjuhë tjetër është vetëm për lehtësi dhe nuk detyron ndonjërin nga palët.
- c. Këto Kushte hyjnë në veprim për përfitim të dhe bëhen të detyrueshme përkatësisht me pasuesin dhe të caktuarin e SMG-së dhe tuajin.
- d. Këto Kushte mund të caktohen nga SMG-ja, por ju nuk mund t'i caktoni ato pa patur miratimin e mëparshëm me shkrim nga SMG-ja.

- e. Nëse dispozitat e këtyre Kushteve janë ose bëhen të pavlefshme ose të pazbatueshme, dispozitat e mbetura do të vazhdojnë me të njëjtin efekt sikur një dispozita e tillë e pazbatueshme ose e pavlefshme të mos përdorej.
- f. Nëse SMG-ja dështon ose ju dështoni në përmbushjen e ndonjë detyrimi në bazë të këtyre Kushteve, dhe pala tjetër nuk i zbaton detyrimet e tilla, dështimi për t'i zbatuar në çdo rast nuk nënkupton një heqje dorë nga detyrimi për zbatim dhe nuk do të parandalojë zbatimin në ndonjë rast tjetër.
- g. Asnjë gjë që përmbahet në këto Kushte nuk do të konsiderohet që të caktojë SMG-në ose ju si një agjent ose përfaqësues të njëri-tjetrit apo si sipërmarrje të përbashkët ose partnerë.
- h. Nëse SMG-ja ose ju pengoheni ose nuk jeni në gjendje të përmbushni detyrimet tuaja në bazë të këtyre Kushteve për shkaqe që janë të pakontrollueshme nga pala që kërkon këtë dispozitë, performanca e palës së ndikuar nga një gjë e tillë do të zgjatet për periudhën e vonesës ose paaftësisë për ta kryer për shkak të rrethanave të tilla.
- i. Titujt dhe diçiturat janë vetëm për lehtësi.

### **PYETJE?**

Nëse keni pyetje në lidhje me Përdorimin e këtyre Kushteve ose Shërbimet e SMG-së, na kontaktoni në [privacyofficer@smg.com](mailto:privacyofficer@smg.com).

Gjithashtu, mund të na shkruani në:  
Service Management Group, LLC  
Për: Përgjegjësi për Mbrojtjen e të Dhënave  
1737 McGee Street  
Kansas City, MO 64108

®/TM Markat Tregtare © Service Management Group, LLC 2017. Të gjitha të drejtat të rezervuara.